



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE
 Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 345
 Datë: 27.02.2026

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË
 DIPLOMËS MASTER**

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	DEPARTAMENTI KOMUNIKACION
Titulli i punimit	“Analiza e formave të kontrollit të kryqëzimeve dhe implementimi i kontrollit automatik në qytetin e Podujevës” <i>Angl. “Analysis of Intersection Control Methods and Implementation of Automatic Traffic Control in the City of Podujeva”</i>
Kandidati	Bsc. Filloreta Gashi
Mentori	Prof. Asoc. dr. Gëzim Hoxha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 19.05.2025 Vendimi Nr.: 749

Konkluzion

Punimi i masterit i kandidatit BSc. Filloreta Gashi i përmbush kushtet metodologjike, profesionale-shkencore dhe etike për një punim të nivelit Master. Punimit i është bashkëngjitur deklarata e studentit për punë autentike. Në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Rregullores për studime master, Komisioni për vlerësim, unanimisht dhe me kënaqësi:




PROPOZON

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë raportin për vlerësimin e punimit të masterit me titull:

“Analiza e formave të kontrollit të kryqëzimeve dhe implementimi i kontrollit automatik në qytetin e Podujevës”, të kandidatit BSc. Filloreta Gashi, dhe të bëjë procedimin e mëtejme për mbrojtje publike të punimit.

Prishtinë: 26/02/2026

Komisioni:

1. Prof. asoc. dr. Arlinda Rrecaj  - kryetar
2. Prof. asoc. dr. Gëzim Hoxha  -mentor
3. Prof. asoc. dr. Fitore Abdullahu  - anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

ABSTRAKTI

Ky hulumtim trajton analizën e formave të kontrollit në kryqëzime dhe gjithashtu vlerëson mundësitë e implementimit të kontrollit automatik të trafikut në qytetin e Podujevës.

Me rritjen e shkallës së motorizimi dhe gjithashtu zhvillimin ekonomik, janë krijuar sfida të reja serioze në menaxhimin e trafikut në qytetet e Kosovës, kryesisht qytetet e mëdha, e po ashtu në pikat kritike të rrjetit rrugor.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është analiza e gjendjes ekzistuese të kryqëzimeve dhe vlerësimi i performacës së tyre me anë të parametrave të trafikut si kapaciteti, shpejtësia vonesat kohore si dhe modelimi me qëllim rritjen e cilësisë së operimit të trafikut në zonën urbane të Podujevës.

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim përfshinë analizën e formave të kontrollit në udhëkryqet, gjithashtu mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të trafikut për gjithsej pesë udhëkryqe kryesore në rrjetin rrugor të qytetit të Podujevës, si dhe gjithashtu simulimi i trafikut. Me anë të analizës dhe simulimit të trafikut dhe kalkulimeve të nevojshme është arrit të vlerësohet niveli aktual i shërbimit për secilin udhëkryq. Nga kjo analizë rrjedhë se një pjesë e këtyre udhëkryqeve ka nivel jo të mirë të shërbimit ku ka vonesa, në orët e pikut.

Si përfundim, ky hulumtim argumenton se, implementimi i sistemeve automatike apo adaptive paraqet një zgjidhje të mirë të qëndrueshme për përmirësimin dhe funksionimin me të mirë të rrjetit rrugë në Podujevë, në këtë mënyrë rritet siguria, lëvizshmëria më pak ndotje nga trafiku.

Fjalë kyçe: Siguria, kontrolli automatik, kryqëzim, sinjalizim, nivel shërbimi.